



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:197244
Datë: 16.12.2024
Numri i dokumentit: 06600191

2024:197245

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Armend Ahmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Fitore Hasani Ismaili, në çështjen juridike të paditësve Sh. N, N.S dhe F. R. O të gjithë nga Ferizaj, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Visar Rrecaj, me seli në Prishtinë rr. "Nekibe Kelmendi", kundër të paditurës Spitali Rajonal në Ferizaj, QKUK me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kompensimin e shtesës në pagë, vlera e kontestit 3,100.00€, pas shqyrtimit të parashtresës të datës 20.11.2024, ndërsa më datë 16.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësve Sh. N, N.S dhe F. R. O, kundër të paditurës Spitali Rajonal në Ferizaj, QKUK me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e shtesës në pagë.

A r s y e t i m

Paditësit Sh. N, N.S dhe F. R. O, përmes të autorizuarit të tyre me datë 12.07.2024, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Spitali Rajonal në Ferizaj, QKUK me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensimin e shtesës në pagë.

Gjykata me datë 20.11.2024, nga i autorizuari i paditësve av. Visar Rrecaj, pranë kësaj gjykate ka pranuar parashtresën për tërheqje të padisë, në çështjen objekt kontesti kompensimin e shtesës në pagë. Meqë në gjykatë nuk ka mbërritur përgjigja në padi e të paditurit, gjykata nuk ia dërgoi parashtresën e paditësve për deklaram të njëjtit.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:197244
Datë: 16.12.2024
Numri i dokumentit: 06600191

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr. 2024:197245, me datë 16.12.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.